



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaçica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1260
Dt 01.10.2020

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2020, mori:

VENDIM

1. Lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët e vitit të fundit në nivelin bachelor të studimeve në njësitë akademike të Universitetit të Mitrovicës, të cilët nuk kanë arritur t'i përfundojnë studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të sërishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.
2. Vazhdimi i kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët nga pika I e këtij vendimi lejohet përfundimisht deri më 30.09.2021.
3. Studentët të cilët nuk arrijnë që, brenda periudhës së lejuar sipas pikës II të këtij vendimi, të përfundojnë studimet (të diplomojnë), me kërkesë të veçantë drejtuar komisionit të studimeve të njësisë përkatëse akademike duhet t'i nënshtrohen ndryshimit të programit dhe provimeve diferenciale të cilat ia cakton ai komision.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Senat.


Arsyetim

Senati, pasi shqyrtoi me kujdes kërkesën e njësisë akademike dhe studentëve për lejimin e vazhdimit të kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët e vitit të fundit në nivelin bachelor të studimeve në njësitë akademike të Universitetit të Mitrovicës, të cilët nuk kanë arritur t'i përfundojnë studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të sërishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet, e konsideroi kërkesën të arsyeshme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.

Prof. dr. Alush Musaj


Rektor i UMIB-it

